

IEKA



Instituti i Ekspertëve
Kontabël të Autorizuar

KUJTESË

2021

Të nderuar auditues ligjorë, anëtarë të IEKAs!

Ju uroj shëndet në familjet tuaja dhe një vit të mbarë e të suksesshëm në 2021!

Në pjesën e parë të vitit 2020, të gjithë ne u përballëm me përhapjen e shpejtë globale të pandemisë COVID-19. Brenda një kohe të shkurtër, bota ndryshoi rrënjësisht shumë aspekte të normalitetit, të cilat kurrë më parë nuk ishin imagjinuar. Megjithatë, duke parë se pandemia do të zgjaste, ashtu si e gjithë bota, ne u përshtatëm me mënyrën e re, atë të punuarit në distancë. Ky realitetet i ri shpejt rezultoi po aq efektiv sa mënyra “tradicionale e të punuarit”. Kështu, ja dolëm të përfundonim me sukses dhe në kohë programin tonë.

Duke vlerësuar faktin që Covid-19 nuk është vetëm një emergjencë shëndetësore por edhe ekonomike, gjatë kësaj periudhe nga IEKA u shtua informimi në kohë reale i anëtarëve, në funksion të nevojave të tyre për të marrë informacione në lidhje me ndryshimet më të fundit në legjislacion, masat e vazhdueshme të marra nga autoritetet, udhëzimet e qeverisë, etj. Një pjesë e rëndësishme e këtij komunikimi i është kushtuar udhëzimeve praktike dhe ideve të ndryshme për mënyrën se si duhet të veprojnë audituesit në këto kohë të pazakonta veçanërisht me klientët e auditimit.

Auditimi i pasqyrave financiare në kushtet e Covid-19, ka qenë dhe mbetet sfida më e madhe për audituesit ligjorë. Me qëllim sigurimin e një cilësie të lartë të auditimit edhe në kushtet e jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia, audituesit duhet të mbajnë parasysh zbatimin e kërkesave të SNA-ve, veçanërisht ato që lidhen me vlerësimin e rrezikut të auditimit, sigurimin e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit si dhe kërcënimin e shkaktuar nga rreziqe të reja si ato të vijimësisë së entitetit, etj. IEKA ka një rol të vecantë dhe të padiskutueshëm në mbështetjen e anëtarëve të saj dhe përmes tyre të entiteteve që veprojnë në vendin tonë.

Në këtë **KUJTESË**, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj, disa kërkesa aktuale që duhet të vlerësohen dhe mbahen parasysh nga Audituesit Ligjorë gjatë kryerjes së angazhimeve profesionale për vitin 2021, për të ofruar shërbime profesionale me cilësi më të lartë për klientët e tyre duke garantuar mbrojtjen e interesit publik nga njëra anë si dhe për të kontribuar në përmirësimin e imazhit dhe rritjen e reputacionit të profesionit në anën tjetër.

Në përmbushje të objektivit dhe me qëllim që audituesit ligjorë, të realizojnë auditimin e pasqyrave financiare vjetore individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare me cilësi të lartë, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), vazhdon

të mbetet i fokusuar në edukimin e anëtarëve për zbatimin e standardeve të auditimit, të raportimit financiar dhe ligjeve e rregullave të organizimit të profesionit.

Sfida e profesionit të audituesit ligjor edhe në vitin 2021 mbetet ajo e rritjes së reputacionit të profesionit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së punës bazuar në zbatimin e standardeve profesionale dhe rritjes së gamës së shërbimeve që mund të ofrojë çdo auditues ligjor, anëtar i IEKAs.

Për arritjen e këtij qëllimi, Audituesi Ligjor duhet të sigurojë njohjen sa më të mirë të kërkesave të SNA-ve dhe zbatimin rigoroz të tyre, Standardizimin e procedurave të auditimit dhe ndërgjegjësimin për të kryer auditime cilësore.

Me qëllim sigurimin e njohjes sa më të mirë të kërkesave të SNA-ve, IEKA ka ndjekur të gjitha ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB) dhe ka përkthyer e rishikuar në gjuhën Shqipe publikimin e tij më të fundit, Manualin e Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura (volumi i parë dhe volumi i tretë), botimi i vitit 2018 si dhe Kodin e Etikës së IFAC-ut.

Nga data 18 Shtator 2019 çdo auditues ligjor ka në adresën e tij të postës elektronike (e-mail), Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të rishikuara, në linkun

<http://ieka.al/internal-content/index/id/d819c27e114b17ebff8f3fc57d84379a>

Në këtë Kujtesë tërheq vëmendjen tuaj për disa kërkesa ligjore të rëndësishme që duhet të mbahen parasysh gjatë ushtrimit të profesionit.

I. Respektimi i kërkesave të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar me ligjin 47/2016 dhe të Kodit të Etikës, gjatë Auditimit Ligjor të Pasqyrave Financiare.

Mbi ushtrimin e profesionit të Audituesit Ligjor

Ligji 10091 datë 05.03.2009 “Mbi auditimin ligjor, organizimin e profesionit të AL dhe të KM” (i ndryshuar) si dhe Kodi i Etikës kanë përcaktuar qartazi kur duhet filluar ushtrimi i profesionit të Audituesit Ligjor, si ushtrohet ky profesion dhe cilat janë papajtueshmëritë.

Audituesit ligjorë kanë të drejtë të kryejnë veprimtarinë e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, si edhe të kryejnë shërbime të tjera apo shërbime të lidhura **vetëm pasi regjistrohen në regjistrin publik**, që mbahet dhe përditësohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.

Audituesi ligjor mund ta ushtrojë profesionin a) në mënyrë individuale; b) si një ortak/ aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese; c) i punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.

Sipas Kodit të Etikës së IEKAs ushtrimi i profesionit të Audituesit Ligjor (person fizik ose shoqëri, konsiderohet i papajtueshëm me:

- Çdo pozicion të punësuar në çfarëdo veprimtari tjetër, me përjashtim të punësimit tek një auditues ligjor tjetër ose një shoqëri auditimi e regjistruar në Regjistrin publik të AL.
- Ushtrimin në mënyrë të pavarur të çdo profesioni tjetër.
- Çdo angazhim ose akt të natyrës që dëmton drejtpërdrejt a tërthorazi pavarësinë dhe ndershmërinë e anëtarit të IEKAs.
- Çdo angazhim, çdo akt tregtie a ndërmjetësimi, çdo mandat tregtar, përfaqësimi gjyqësor në çështjet që interesojnë klientët e tij, çdo punë kontrolli në një entitet, në të cilin ai ka drejtpërdrejt a tërthorazi interesa.

Audituesve Ligjorë ju lejohet vetëm ushtrimi i veprimtarisë së mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe pjesëmarrja në seminare, konferenca apo veprimtari të ngjashme me to. (Neni 32 i ligjit dhe K.E. 20.2.2) Licenca e EKR nuk lejohet të përdoret në më shumë se një entitet (ose person fizik ose shoqëri) që ka si objekt auditimin ligjor dhe jo-ligjor të pasqyrave financiare. (K.E. 20.2.11)

Përditësimi i të dhënave të regjistrit publik

Audituesi ligjor dhe shoqëria audituese njoftojnë organizatën profesionale të audituesve ligjorë për ndryshimin e informacionit të detyrueshëm për publikim dhe të regjistruar në regjistrin publik sapo ndryshimi të ketë ndodhur.

Kualifikimi i Vijueshëm profesional

IEKA synon që të gjithë anëtarët e saj të përmbushin kërkesat e Kualifikimit të vijueshëm profesional, në mënyrë që të ruajnë dhe të përmirësojnë kompetencat e tyre profesionale. Kjo është përgjegjësi dhe detyrim si ndaj vetes, ndaj klientëve tuaj, por edhe ndaj IEKAs.

Sipas ligjit 10091, audituesit ligjorë kanë detyrimin të kryejnë 40 orë kualifikim të vijueshëm profesional. **Kryerja e kualifikimit të vijueshëm profesional është kusht për të qenë të regjistruar në regjistrin publik të IEKAs.** Në rastet kur Audituesi Ligjor ka munguar më shumë se 20% të kohës së parashikuar për kualifikimin e vijueshëm, do të organizohet nga IEKA testimi i njohurive.

Pjesëmarrja në kualifikimin e vijueshëm gjenerohet automatikisht nga platformat në të cilat kryhet kualifikimi.

Konflikti i interesit

Sipas nenit 33 të ligjit të auditimit përcakton se Audituesi Ligjor ose shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, duhet të jenë të pavarur nga personi juridik që auditohet dhe nuk duhet të marrin pjesë në vendimmarrjen e këtij entiteti.

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese nuk duhet ta kryejnë auditimin nëse ekziston ndonjë lidhje, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, financiare, biznesi ose punësimi ndërmjet audituesit ligjor, shoqërisë audituese, apo rrjetit të audituesve dhe personit juridik që auditohet, kur kjo lidhje shkel pavarësinë e audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese.

Konfidencialiteti dhe sekreti profesional

Në nenin 34 të ligjit të auditimit përcaktohet se Informacionet dhe dokumentet që përdoren ose mbi të cilat merret dijeni nga audituesi ligjor apo shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, mbrohen nga konfidencialiteti dhe sekreti profesional.

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që ka ndërprerë angazhimet në një auditim të caktuar, ose një ish-auditues ligjor ose ish-shoqëri audituese, do të vazhdojnë t'u nënshtrohen dispozitave të pikave 1 e 2 të këtij neni, në lidhje me auditimet e kryera.

Pavarësia dhe objektiviteti

Pronarët, ortakët ose aksionarët e një shoqërie audituese, si dhe anëtarët e organeve të drejtimit apo administrimit të kësaj shoqërie ose të një shoqërie të lidhur me të, nuk lejohen të ndërhyjnë në kryerjen e një auditimi në çdo lloj mënyre, që rrezikon pavarësinë dhe objektivitetin e audituesit ligjor, që kryen auditimin.

Emërimi i Audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese

Ligji 10091, neni 42 ka përcaktuar se – për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të entiteteve të biznesit caktohen AL, persona fizik, apo shoqëri auditimi, emërimi i të cilëve bëhet çdo vit nga: mbledhja e përgjithshme e aksionarëve për shoqëritë aksionare (SHA), ose nga asambleja e ortakëve për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Shoqëritë tregtare, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit (SKK) janë të detyruara që për auditimin ligjor të emërojnë të paktën, një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar jo më pak se dy auditues ligjorë; ose dy auditues

ligjorë, persona fizikë; një auditues ligjor person fizik dhe një shoqëri auditimi, që ka të regjistruar, të paktën, një auditues ligjor; apo dy shoqëri auditimi, që kanë të regjistruar, përkatësisht, vetëm një auditues ligjor.

Gjithashtu, ligji Nr.9723, (05/2007) “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” neni 43.3 (b) ka përcaktuar të detyrueshëm regjistrimin e vendimit të emërimit të AL-ve. Nga AL-të kërkohet që të bëhet kujdes që klientët të pasqyrojnë emërimin dhe ndryshimin në emërim në kohën e duhur, në të dhënat e detyrueshme që klienti i deklaron në QKR dhe kjo e fundit i publikon duke i dhënë kështu akses publikut.

Nënshkrimi i Raportit të Auditimit

Raporti i auditimit ligjor do të nënshkruhet nga të paktën njëri prej audituesve ligjorë që kryejnë auditimin në emër të shoqërisë audituese (Ligji, Neni 43/1).

Afati i rotacionit

Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj respektimin e kërkesave të Kodit të Etikës për rotacionin (pika 20.2.12) sipas të cilës çdo Auditues Ligjor, që është person fizik apo audituesi ligjor, ortak kryesor i angazhimit i një shoqërie auditimi, që ka mbushur kohën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të një shoqërie prej **7 vite rresht duhet të zëvendësohet**. Personi fizik apo ortaku i angazhimit i shoqërisë së auditimit mund të rimarrë pjesë në auditimin e pasqyrave financiare të kësaj shoqërie vetëm pas mbarimit të një afati kohor prej të paktën, dy vite rresht.

II. Zbatimi i Kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit

Shërbimi i Auditimit Ligjor dhe Dhënia e Sigurisë vazhdon të mbetet një nga shërbimet më të rëndësishme të profesionit tonë çka përbën dallimin esencial me profesionet e tjera. Auditimi dhe Dhënia e Sigurisë luajnë një rol thelbësor në funksionimin e ekonomisë për të siguruar besimin e aksionarëve aktualë dhe të atyre të ardhshëm si dhe të një varg përdoruesish në lidhje me informacionin financiar të raportuar dhe të publikuar nga njësitë ekonomike. Kjo do ti ndihmojë ata në përdorimin e këtij informacioni në vendimarrjen e tyre.

Për këtë qëllim është e rëndësishme të sigurohet nga çdo auditues njohja, kuptimi dhe zbatimi i kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Sipas SNA 210 – Audituesi Ligjor duhet të njohë dhe kuptojë mirë parakushtet e angazhimit përpara se të marrë përsipër angazhimin e auditimit, d.m.th., ai duhet të vlerësojë paraprakisht nëse kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar që përdoret në përgatitjen e pasqyrave financiare është i pranueshëm, dhe faktin që drejtimi i entitetit i njeh dhe i kupton përgjegjësitë e tij. Përpara marrjes përsipër të angazhimit, AL duhet të vlerësojë rrezikun e auditimit dhe të formalizojë marrjen përsipër të detyrës nëpërmjet një kontrate ose letre angazhimi.

Sipas SNA 230 – Audituesi Ligjor duhet të zbatojë kërkesat dhe udhëzimet specifike lidhur me dokumentimin e punës gjatë procesit të auditimit të pasqyrave financiare. Për çdo angazhim auditimi, Audituesi Ligjor ose shoqëria e auditimit duhet të krijojë një dosje të plotë që përmban identitetin e klientit, të drejtuesve të tij, si dhe të gjithë dokumentacionin, evidencën e marrë ose të përgatitur prej tij gjatë kryerjes së auditimit, konkluzionet, etj.

SNKC 1 kërkon që firmat të vendosin politika e procedura, të cilat garantojnë përfundimin në kohë të sistemimit të dosjeve të auditimit. Periudha prej 60 ditësh pas datës së raportit të audituesit, si rregull përbën kufirin limit të kohës, brenda të cilës duhet të përfundohet dhe të sistemohet dosja përfundimtare e auditimit.

Pas kryerjes së sistemimit të dosjes përfundimtare të auditimit dhe deri në përfundim të periudhës së parashikuar për ruajtjen e saj, audituesi nuk lejohet të fshijë ose të heqë dokumentet e auditimit të çdo lloji natyre përpara përfundimit të periudhës së ruajtjes së tij.

SNKC 1 kërkon që firmat të vendosin politika dhe procedura për mbajtjen në ruajtje të dokumentacionit të angazhimit. Periudha e ruajtjes për angazhimet e auditimit si rregull nuk është më e shkurtër se pesë vjet duke filluar nga data e raportit të audituesit, ose nga data e raportit të audituesit të grupit.

Sipas SNA 300 – Audituesi duhet të hartojë dhe të dokumentojë planifikimin e auditimit i cili përfshin hartimin e strategjisë të përgjithshme të auditimit që përcakton qëllimin, kohën dhe drejtimin e auditimit dhe që jep udhëzime për zhvillimin e planit të auditimit.

Përpara se të nisë një auditim që kryhet për herë të parë, audituesi duhet: (a) Të kryejë procedurat e kërkuara nga SNA 220 në lidhje me pranimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimin specifik të auditimit; dhe (b) Të komunikojë me audituesin e mëparshëm, kur ka patur ndryshim të audituesve, në pajtim me kërkesat etike të përshtashme.

Komunikimi me audituesin e mëparshëm ende mbetet një çështje për tu pasur në vëmendje. Një komunikim i duhur e ndihmon audituesin pasardhës për të njohur më mirë klientin e tij të auditimit dhe për vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat e tij financiare. Një gjë e tillë është parashikuar edhe në Kodin e Etikës të IEKAs.

Më poshtë janë dhënë shkurtimisht disa nga kërkesat:

- Audituesi ligjor që thirret për të zëvendësuar një AL tjetër, nuk duhet të pranojë angazhimin, po qe se ekzistojnë arsye profesionale apo edhe arsye të tjera për mospranimin e angazhimit, siç janë rrethanat që kërcënojnë respektimin e parimeve themelore. (K.E. 21.4.1)
- Audituesi ligjor që thirret nga një klient për të zëvendësuar një AL tjetër, mund ta pranojë angazhimin vetëm pasi të jetë informuar me shkrim nga AL parardhës dhe të jetë siguruar që kërkesa nuk rrjedh nga dëshira e klientit për të shmangur efektet e kryerjes rigoroze të detyrave profesionale. AL pasues duhet të mënjanojë çdo kritikë personale ndaj paraardhësit të tij. (K.E. 21.4.2)
- Para se të marrë përsipër angazhimin e auditimit të pasqyrave financiare, një Auditues Ligjor duhet të ketë marrë nga klienti një dokument që përligj pagimin e honorareve për paraardhësin e tij (K.E. 21.4.3). Në të gjitha rastet e tjera, duhet të mbahen mirë parasysh kërkesat e SNA-ve dhe të kodit të etikës për komunikimin me AL-në paraardhës dhe ky komunikim duhet të dokumentohet në fletët e punës dhe në dosjen e auditimit.

Për të qenë në pajtim me kërkesat e Kodit të Etikës, Ju duhet që të nënshkruani kontratën, apo letrën e angazhimit, kur të jeni siguruar që klienti ka shlyer detyrimin e pagesës së honorarit për audituesin ligjor paraardhës.

Sipas SNA 315 – Audituesi duhet të mbajë parasysh që të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale, për shkak të mashtrimit ose gabimit, në nivel të pasqyrave financiare dhe në nivelet e pohimit, nëpërmjet njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit, duke siguruar në këtë mënyrë një bazë për projektimin dhe zbatimin e procedurave të nevojshme të auditimit si reagim ndaj rreziqeve të vlerësuara të anomalisë materiale.

III. Afatet kohore të auditimit dhe tarifa orare e pagesës

Audituesit Ligjor i ndalohet të zbatojnë tarifa të ulëta për qëllime të sigurimit të klientelës. Asambleja e përgjithshme e anëtarëve ka miratuar shumën prej 3,000 lekë/ora si tarifë normale orare për kryerjen e auditimit ligjor. (Vendimi 29.06.2011)

Tarifa orare normale për auditimet ligjore duhet të orientojë anëtarët AL në përcaktimin e honorareve gjatë misionëve të auditimit të Pasqyrave Financiare vjetore të entiteteve dhe duhet të shërbejë si një kufi minimum që ofrohet nga të gjithë anëtarët për shërbimin e auditimeve ligjore.

Afatet kohore të auditimit ligjor janë miratuar nga BMP me Vendimin Nr.1 datë 09.03.2015.

Niveli referues minimal kohor (afati kohor) për auditim e Pasqyrave Financiare është **40 orë**. (Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve datë 09.03.2015)

Niveli referues maksimal kohor (afati kohor) për auditim të pasqyrave financiare me total aktiv të bilancit dhe të ardhura gjithsej deri në 2 miliard lekë është **160 orë**. (Vendimi datë 09.03.2015)

Përcaktimi i afateve kohore të auditimit është objekt negocimi midis audituesit dhe entitetit në zbatim të kërkesave të SNA-ve dhe finalizohet me nënshkrimin e letrës së angazhimit apo kontratës midis audituesit dhe entitetit (klientit).

IV. Cilësia e auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të njësive ekonomike

Kontrolli i cilësisë së auditimeve të pasqyrave financiare vjetore të njësive ekonomike bëhet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) (Ligji, Neni 38). Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të delegojë kryerjen e kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike që nuk janë me interes publik, tek organizata profesionale e audituesve ligjorë. Një nga objektivat e IEKAs për vitin 2021 është nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me BMP në të cilën ndër çështjet kryesore është delegimi i kontrollit të cilësisë së auditimeve për Entitetet jo me Interes publik.

V. Respektimi i kërkesave të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Audituesit ligjorë janë subjekt i Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", i ndryshuar, neni 3, gërma (gj), **kur përgatisin transaksione ose kryejnë shërbime për klientët e tyre për veprimtaritë e mëposhtme:**

- i) kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, administrimin e parave, të letrave me vlerë ose të aseteve të tjera;
- ii) administrimin e llogarive bankare;
- iii) administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare;
- iv) krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë dhe/ose organizimeve ligjore;
- v) marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare.

Sipas nenit 11 pika 1(a) të Ligjit 9917 kërkohet që subjektet duhet të hartojnë, të përditësojnë dhe të zbatojnë në mënyrë efektive rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme, të cilat, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e subjektit, parashikojnë marrjen e masave të përshtatshme për të kuptuar rrezikun e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit që mund të lindë nga klientë ose transaksione.

Raportimi tek Autoriteti Përgjegjës bëhet në rastet:

1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.
2. Kur subjekti, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t'ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe 18 të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja dijeni, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejimin e transaksionit ose nxjerrjen

e urdhrit të bllokimit. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit.

3. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.000.000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve. Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen me organet apo ndërmarrjet publike.

VI. Kuotat Profesionale në Vitin 2021

Kuotat profesionale për të cilat audituesi ligjor ka detyrimin statutor për ti paguar, përbëhen nga:

Kuota fikse dhe Kuota variable.

Audituesi ligjor ka detyrimin statutor që t'i paguajë kuotat në afatet e caktuara (neni 5.2.2 i Statutit).

Në zbatim të nenit 29 të Statutit dhe të Vendimit nr. 146 datë 17.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve:

- **Kuota fikse** për vitin 2021 është 60.000 lekë dhe afati i pagesës është deri në **28 shkurt 2021**;
- **Kuota variabël** e llogaritur bazuar në shumën e honorareve të faturuara nga angazhimet e kryera për vitin 2020, është
 - 0,5% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale nga 0-8 mln lekë
 - 0,3% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale mbi 8 mln lekëdhe afati i pagesës është deri në **20 janar 2021**.

Për çdo muaj vonesë në pagimin e kuotës, sipas Statutit zbatohet një kamatë vonesë prej 1% në muaj mbi shumën e kuotës së papaguar.

VII. Raportimi i Pasqyrave të Deklarimit të Misioneve të Kryera në Vitin 2020 dhe i PF.

Audituesit Ligjor dhe Shoqëritë e Auditimit, kanë detyrimin të dorëzojnë në Institut (IEKA) në formatin hardcopy dhe në mënyrë elektronike në formatin excel në adresën financa@ieka.al **jo më vonë se data 25 Janar të çdo viti** një pasqyrë që përmbledh sipas kategorive, veprimtaritë/misionet e kryera gjatë vitit paraardhës si dhe shpërblimet (honoraret) e marra si dhe deri në datën 31 mars të çdo viti pasqyrat financiare të nënshkruara për ushtrimin e mbyllur në 31.12.2020. (neni 7.1 i Statutit).

Kur Audituesit Ligjorë e ushtrojnë profesionin e tyre në kuadrin e një shoqërie auditimi të regjistruar në Institut, informacioni i mësipërm dërgohet nga shoqëria dhe nënshkruhet nga administratori. (neni 7.2 i Statutit).

Ju kujtoj se në deklarimet e misioneve duhet të tregohet kujdes për deklarimin e angazhimeve të përbashkëta, të cilat jo vetëm duhet të jenë të deklaruara nga të gjithë audituesit apo shoqëritë e auditimit të bashkëemëruara, por në çdo rast honoraret do të bazohen në faturime të veçanta nga çdo AL të bashkëemëruar.

Të nderuar auditues ligjorë, anëtarë të IEKAs!

Shpresoj që kjo Kujtesë tju vijë në ndihmë kryesisht në respektimin e kërkesave të ligjit, statutit, kodit të Etikës, SNA-ve dhe përmirësimin e cilësisë në kryerjen e misioneve tuaja.

Më lejoni të bëj disa falënderime për të gjithë institucionet, bashkëpunëtorët dhe të gjithë anëtarët e Institutit tonë. Së pari, dëshiroj të falënderoj Këshillin Drejtues, mbështetja e të cilit mundësoi realizimin e veprimtarive të Institutit. Shpresoj që Këshilli do të miratojë së shpejti edhe vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me mbikëqyrësin, ku kryerja nga IEKA e kontrollit të cilësisë për entitetet jo me interes publik do të jetë një nga pikat kryesore të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ju, audituesit ligjorë që edhe në kushtet e jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia COVID 19, arritët të realizoni me sukses angazhimet e auditimit dhe shërbimet e tjera në shërbim të biznesit dhe të interesit të publikut. Shpreh bindjen se audituesit ligjorë, nisur nga niveli i njohurive teknike dhe profesionale, aftësive dhe vlerave etike, do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të profesionit dhe të interesit të publikut për të siguruar që raportet e auditimit pasqyrojnë realitetin dhe shërbimet e tjera shtojnë vlerë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, dëshiroj të shpreh vlerësimin tim për stafin ekzekutiv të IEKAs, i cili edhe pse i vogël në numër, kapërceu vështirësitë e shkaktuar

nga pandemia Covid-19 dhe ja doli të kryejë me sukses informimin e anëtarëve me informacione në lidhje me ndryshimet më të fundit në legjislacion, udhëzimet praktike për mënyrën se si duhet të veprojnë audituesit në këto kohë të pazakonta veçanërisht me klientët e auditimit, publikimin e SNA volumi I dhe volumi III si dhe Kodi i Etikës së IFAC, realizimin e trajnimeve në platformat online etj.

Ju ftoj të gjithëve të zbatojmë me korrektësi standardet profesionale dhe të përmirësojmë cilësinë e punës. Vetëm kështu ne do të mund të shtojmë reputacionin, përmirësojmë imazhin dhe të rritim rolin e profesionit të Audituesit Ligjor. Profesionalizmi, respektimi i Etikës dhe Integriteti duhet të udhëheqin të gjithë veprimtarinë tonë.

Dëshiroj të mbyll fjalën time duke siguruar se Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar mbetet i angazhuar në rrugën e tij për forcimin e profesionit të audituesit ligjor dhe rritjen e reputacionit të emrit të Audituesit Ligjor. Ne jemi besimplotë se do të japim kontributin tonë më të mirë dhe në sajë të bashkëpunimit dhe komunikimit tonë të përbashkët do të arrijmë në zgjidhjet më të mira.

Ju ftoj të kontribuoni me mendime/sugjerime për përmirësime të mëtejshme në çdo çështje që ju e gjykoni të arsyeshme. Mendimet dhe sugjerimet tuaja do të kontribuojnë që IEKA të vazhdojë të zhvillojë më tej vizionin e saj dhe të japë një kontribut real në përmirësimin e proceseve zhvilluese dhe demokratizuese për vendin tonë.

Me Respekt,

Berti Pashko

Kryetar i Këshillit Drejtues

Tiranë, 19 Janar 2021

IEKA



Instituti i Ekspertëve
Kontabël të Autorizuar

IEKA

Rr.Elbasanit, Pall.EDIL AL-IT
P.O Box 1437, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42346 077
Cel: +355 682063069

E-mail: info@ieka.al
Web: www.ieka.al